

të drejtat e
ALLAHUT
mbi robërit e Tij

Shejkh Rabi' ibën Hadij el Medkhalij



Kurani dhe Suneti me kuptimin e Selbësive të këtij Umeti
Selefu.org

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Të gjitha lavdet i takojnë Allahut. Atë e lavdërojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë prej Allahut që të na mbrojë prej sherrit të vetëve dhe të veprave tona. Kush udhëzohet nga Allahu nuk ka kush e devijon, dhe kush devijohet nga Allahu s'ka kush që mund ta udhëzojë.

Dëshmojë se nuk ka të adhuruar të drejtë përveç Allahut, i Cili është një dhe nuk ka ortak; dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Allahut.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ ۖ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ﴿١٢﴾

“O besimtarë. Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë musliman.”¹

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ ۖ وَالْأَرْحَامَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا



“O njerëz. Frikësojuni Zotit tuaj, i cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej tij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre dyve krijoi shumë meshkuj dhe femra. Dhe frikësojuni Allahut, me Emrin e të Cilit ju kërkon të drejtat e ndërsjella dhe ruajini lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”²

¹ Aali-Imran, 102.

² En-Nisa`, 1.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ﴿٧٠﴾ يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ

لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴿٧١﴾

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Atëherë, Ai do t'jua përmirësojë veprat tuaja dhe do t'jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.”³

Më tej:

Fjala më e vërtetë është Fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është Udhëzimi i Muhamedit – *sal-lAllahu alejhi ue selem* –, veprat më të këqija janë ato të shpikurat në Fe, çdo shpikje në Fe është bidat, çdo bidat është devijim dhe secili devijim e ka përfundimin në Zjarr.

E më pas:

U japim mirëseardhjen vëllezërve tanë të nderuar në këtë tubim i cili shpresojmë që të jetë i dobishëm.⁴ Tema është ajo që e dëgjuat, rreth të Drejtave të Allahut – *Tebarake ue Te’ala* – mbi robërit e Tij, e sa të mëdha që janë të Drejtat e Allahut – *Subhanehu ue Te’ala* – mbi robërit e Tij!?

S’ka dyshim se të gjitha përpjekjet e robërve janë të pamjaftueshme për të përmbushur falenderimin e Allahut për një begati të vetme nga begatitë e Tij të vogla që u ka dhënë atyre. Tema është interesante, lidhet me shumë ajete dhe një sërë çështjesh dhe të gjitha bashkë takohen në një rrjedhë të vetme: Emrat dhe Cilësitë e Tij, veçimi i Allahut në Rububijen e Tij dhe veçimi i Tij në adhurimin e Tij – *Subhanehu ue Te’ala*.

³ El-Ahzab, 70-71.

⁴ **Shënim i përkthyesit:** Kjo është një ligjëratë e Shejkhut të Nderuar, Kolosit Rabi’ Ibn Hadij el-Medkhalij (*hafidhahullah*), e mbajtur në Xhaminë e Shejkh Ibn Bazit (*rahimehullah*) në Mekken e Shenjtë, ditën e Xhuma, më datë 12 Rabi’ eth-Thani 1429 Hixhrij, e cila përkon me datën 19 Prill 2008 Miladij.

Dhe argument për këtë janë të gjitha krijesat e Tij – *Subhanehu ue Te'ala* – dhe mrekullitë e Tij në univers. Unë do t'u shpalos ato ajete, të cilat janë argumente që vërtetojnë obligimin e përmbushjes së kësaj të Drejte ndaj Allahut, Zotit të botëve.

Ajete për universin me të cilat argumentohet për prioritetin e Teuhidit të adhurimit, të cilin e njihni. Dhe nga këto ajete është Fjala e Allahut të Madhëruar dhe të Lartësuar:

قُلْ لِعِبَادِيَ الَّذِينَ ءَامَنُوا يُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُنْفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا وَعَلَانِيَةً مِّن قَبْلِ
أَن يَأْتِيَ يَوْمٌ لَا بَيْعَ فِيهِ وَلَا خِلَالٌ ﴿٦١﴾ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَأَنْزَلَ
مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَّكُمْ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْفُلْكَ لِتَجْرِيَ
فِي الْبَحْرِ بِأَمْرِهِ ۖ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْأَنْهَارَ ﴿٦٢﴾ وَسَخَّرَ لَكُمُ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ دَآئِبِينَ ۖ
وَسَخَّرَ لَكُمُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ ﴿٦٣﴾ وَءَاتٰكُم مِّن كُلِّ مَا سَأَلْتُمُوهُ وَإِن تَعُدُّوا نِعْمَتَ اللَّهِ
لَا تُحْصُوهَا ۚ إِنَّ الْإِنسَانَ لَظَلُومٌ كَفَّارٌ ﴿٦٤﴾

“Thuaju robërve të Mi, të cilët besojnë: Le të falin namazin dhe le të japin fshehurazi dhe haptazi nga ajo që Ne ua kemi dhënë, para se të vijë dita në të cilën s’ka as tregti e as miqësi. Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe Ai lëshon ujë nga qielli, e nëpërmjet tij nxjerr fruta si furnizim për ju. Ai i ka vënë në shërbimin tuaj anijet, që me lejen e Tij, ju të lundroni me ato nëpër dete dhe ka vënë në shërbimin tuaj lumenjtë. E po ashtu u ka vënë në shërbim edhe Diellin dhe Hënën, që lëvizin vazhdimisht. Ai ka vënë në shërbimin tuaj edhe natën dhe ditën. Ai ju jep gjithçka që i kërkon. Edhe nëse përpiqeni t’i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t’i numëroni dot. S’ka dyshim se njeriu është me të vërtetë i padrejtë dhe mosmirënjohës.”⁵

⁵ Ibrahim, 31-34.

Ai e nënshtroi tërë këtë univers dhe i nënshtroi qiejt, tokën, kodrat, detrat, diellin, hënën, natën, ditën, si dhe begati të shumta nga Allahu – *Tebarake ue Te’ala*, begati të cilat i ka përmendur në shumë ajete të Tij. Të gjithë këto i ka nënshtroar për hir të këtij njeriu të dobët.

وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ ۚ وَالْأَرْضُ جَمِيعًا قَبْضَتُهُ يَوْمَ الْقِيَمَةِ وَالسَّمَوَاتُ

مَطْوِيَّاتٌ بِيَمِينِهِ ۚ سُبْحَنَهُ وَتَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿١٧﴾

“Ata nuk e kanë vlerësuar e nuk e kanë madhëruar siç duhet Allahun. Në Ditën e Kijametit, e tërë Toka do të jetë në grushtin e Tij, ndërsa qiejt do të mbështillen në të djathtën e Tij. I Përsosur është Ai dhe i Lartësuar mbi idhujt që ia shoqërojnë Atij (në adhurim).”⁶

Pastaj, Allahu – *Tebarake ue Te’ala* – tha në suren en-Neml:

قُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ وَسَلَامٌ عَلَىٰ عِبَادِهِ الَّذِينَ اصْطَفَىٰ ۚ ءَاللهُ خَيْرٌ أَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٥١﴾

“Thuaj (o Muhamed): “Lavdet janë për Allahun dhe shpëtimi qoftë për robërit e Tij të zgjedhur. Kush është më i mirë, Allahu apo ata që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)?!”⁷

Robërit e tij të zgjedhur janë Pejgamberët, dhe thuhet se janë edhe Sahabët. Ajeti mund t’i përfshijë që të gjithë, përfshin Sahabët dhe përfshin Pejgamberët – ‘*alejhimus-salatu ues-selam*.

ءَاللهُ خَيْرٌ أَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٥١﴾

“Kush është më i mirë, Allahu apo ata që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)?!”⁸

⁶ Ez-Zumer, 67.

⁷ En-Neml, 59.

⁸ En-Neml, 59.

Ky është qortim për ata. Nuk krahasohet Allahu me këta të adhurar të pavlerë, qofshin objekte apo frymorë, si dhe të adhurarit e tjerë pos këtyre. Pra, këtu mirësia nuk ka për qëllim krahasimin, porse ky është qortim për këta injorantë e budallenj të devijuar.

أَمَّنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَأَنْزَلَ لَكُمْ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَنْبَتْنَا بِهِ حَدَائِقَ
ذَاتِ بَهْجَةٍ مَا كَانَ لَكُمْ أَنْ تُنْبِتُوا شَجَرَهَا ۗ أَلَيْسَ اللَّهُ بِلَهُمْ قَوْمٌ يَعْدِلُونَ

“A ka më të mirë se Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe lëshon për ju nga qielli ujë, me të cilin krijon kopshte të mrekullueshme?! Ju nuk mund t’i bëni pemët të rriten (pa këtë ujë). Vallë, a ka të adhurar tjetër me të drejtë krahas Allahut?! Jo, por ata janë njerëz që i veshin (Allahut) të barabartë me Atë.”⁹

Pra, ky ajet është qortim dhe tërheqje e vërejtjes për idhujtarët, të cilët i bëjnë Allahut ortak dhe të barabartë. Ata i bëjnë këta idhuj të barabartë me Allahun – *Tebarake ue Te’ala*, kurse ata nuk kanë në dorë për veten e tyre as dobi e as dëm, as vdekje e as jetë, e as ringjallje. Pra, ata i marrin këto idhuj për t’i adhurar.

Ai që ka krijuar këta qiej, këto toka si dhe këto krijesa është Ai i Cili e meriton adhurimin, kurse këta (të adhurarit e mushrikëve) nuk meritojnë asgjë. Madje shumë nga këta të adhurar e adhurojnë Allahun – *Tebarake ue Te’ala* – prej nga nuk e dinë këta injorantë, siç do të sqarohet në vijim, *in shaa`Allah*:

أَمَّنْ جَعَلَ الْأَرْضَ قَرَارًا وَجَعَلَ خِلَالَهَا أَنْهَارًا وَجَعَلَ لَهَا رَوَاسِيَ وَجَعَلَ بَيْنَ
الْبَحْرَيْنِ حَاجِزًا ۗ أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٦١﴾

“A ka më të mirë se Ai që e ka bërë Tokën të qëndrueshme, ka bërë në të lumenj, ka ngritur në të male dhe ka bërë midis dy deteve pengesë të

⁹ En-Neml, 60.

padukshme?! Vallë, a ka krahas Allahut, të adhuruar tjetër?! Jo, por shumica e tyre janë të paditur.”¹⁰

A ka ndonjë të adhuruar tjetër krahas Allahut që t’i ketë bërë këto gjëra i vetëm apo bashkë me Allahun?

Pra, Allahu është Ai që i shpiku këto gjëra, Ai është që meriton të adhurohet dhe nuk lejohet që të merren të tjerët si të barabartë me Të. Tejet i Lartësuar është Allahu nga kjo gjë (që thonë ata)!

Ai tha:

بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٦١﴾

“Jo, por shumica e tyre janë të paditur.”¹¹

Do të thotë se ata nuk e njohin Teuhidin e Allahut dhe faktin që është obligim veçimi i Tij me adhurim e bindje e të mos i bëhet mëkat.

أَمِنْ حُجُبِ الْمُضْطَرِّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ وَيَجْعَلُكُمْ خُلَفَاءَ الْأَرْضِ أَأَلِهَ مَعَ

اللَّهِ قَلِيلًا مَّا تَذَكَّرُونَ ﴿٦٢﴾

“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë atij që është në vështirësi, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë?! Vallë, a ka krahas Allahut të adhuruar tjetër që ta meritojë adhurimin?! Sa pak që reflektoni!”¹²

Shpjegimi i ajetit “**Vallë, a ka krahas Allahut të adhuruar tjetër që ta meritojë adhurimin?!**” është: A ka të adhuruar tjetër që meriton të adhurohet? Apo ndonjë të adhuruar tjetër krahas Allahut që të ketë krijuar këto gjëra? Përgjigja: “Asnjë.” Të gjitha këto krijesa i ka krijuar Allahu –

¹⁰ En-Neml, 61.

¹¹ En-Neml, 61.

¹² En-Neml, 62.

Subhanehu ue Te'ala. Është Ai i Cili e bëri tokën të qëndrueshme dhe ka bërë në të lumenj, ka ngritur në të male dhe ka bërë midis dy deteve pengesë të padukshme, e kështu me radhë... Ai është i Vetmi dhe i paortak në krijim e këtyre gjërave. Prandaj është obligim që Ai të veçohet me adhurim i vetëm. Te Ai t'i kthejmë fytyrat dhe te Ai të përulim ballët, i Përsosuri dhe i Lartësuari nga çdo e metë:

الْشُّوْءَ وَيَكْشِفُ دَعَاةُ إِذَا الْمُضْطَّرُّ يُجِيبُ أَمَّنْ

“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë atij që është në vështirësi, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen...”¹³

Kush? Kush është ai që bën këtë, që u përgjigjet lutjeve të atyre që janë në vështirësi dhe ua largon të keqen? Ai është vetëm Allahu, i Përsosuri dhe i Lartësuari nga çdo e metë.

أَمَّنْ يُجِيبُ الْمُضْطَّرُّ إِذَا دَعَاةُ وَيَكْشِفُ الشُّوْءَ وَيَجْعَلُكُمْ خُلَفَاءَ الْأَرْضِ

“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë atij që është në vështirësi, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë?! ”¹⁴

Ai pason brezat, brez pas brezi, sjell brezat e para dhe sjell brezat e reja, i Përsosuri dhe i Lartësuari nga çdo e metë. A ka ndonjë nga këta të adhuruarit (e mushrikëve) që mund të bëjë një thërmijë nga këto gjëra? I Lartësuar është Allahu nga ajo (që ata i përshkruajnë).

Allahu thotë:

قَلِيلًا مَّا تَذَكَّرُونَ ﴿١٦﴾

“Sa pak që reflektoni!”¹⁵

¹³ En-Neml, 62.

¹⁴ En-Neml, 62.

¹⁵ En-Neml, 62.

Domethënë reflektimi i tyre mbi këto mirësi është shumë i paktë, madje ata janë të zhytur në injorancë e janë të shkujdesur.

أَمَّنْ يَهْدِيكُمْ فِي ظُلُمَاتِ الْبَرِّ وَالْبَحْرِ وَمَنْ يُرْسِلُ الرِّيحَ بُشْرًا بَيْنَ يَدَيْ رَحْمَتِهِ ۖ

أَأَلَّهُ مَعَ اللَّهِ تَعَالَى اللَّهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿١٦﴾

“A ka më të mirë se Ai që ju rrëfen rrugën në errësirat e tokës dhe të detit dhe ju çon erërat si lajmëtare të mëshirës së Tij? Vallë, a ka krahas Allahut të adhuruar tjetër me të drejtë? I Lartësuar është Allahu mbi çdo gjë që ia shoqërojnë (në adhurim).”¹⁶

I Përsosur dhe i Lartësuar është Ai nga çdo e metë!

I Lartësuar është Allahu mbi çdo gjë që ia shoqërojnë.

I Lartësuar është Allahu, Krijuesi, i Plotfuqishmi, Rregulluesi i të gjitha këtyre gjërave.

I Lartësuar, i Pastër dhe i Shenjtë është Ai nga të bërit ortak e të barabartë që të adhurohen bashkë me të Përsosurin e të Lartësuarin nga çdo e metë.

Tejet i Lartësuar është Allahu nga ajo që ata i përshkruajnë.

أَمَّنْ يَبْدَأُ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ

“A ka më të mirë se Ai, që nis krijimin dhe pastaj e ripërsërit atë...”¹⁷

Kush krijon diçka nga kjo? Askush? Sikur të mblidheshin ata që janë në qiell dhe ata që janë në tokë për të krijuar një thërmijë, përveç kësaj t'i krijojnë këta popuj e këto gjenerata dhe këto qenie madhështore, nuk do të kishin mundësi.

¹⁶ En-Neml, 63.

¹⁷ En-Neml, 64.

أَمَّنْ يَبْدُوْا الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيْدُهُ

“A ka më të mirë se Ai, që nis krijimin dhe pastaj e ripërsërit atë...”¹⁸

Pra, ata e pohojnë fillimin e krijimit, ata e shohin, e dëshmojnë këtë dhe e pohojnë këtë, porse refuzojnë me kryeneçësi. Ata tregohen kryeneç në refuzimin e ringjalljes në Ditën e Gjykimit për të dhënë llogari dhe për t’u shpërblyer, si dhe i përgënjeshtrojnë të Dërguarit për këtë. Allahu na ruajt. Pastaj ata i bëjnë ortak e të barabartë Allahut të Përsosur e të Lartësuar nga çdo e metë!

Thuaj: sillni argumentet tuaja që pretendimi juaj është i saktë, se krahas Allahut paska të tjerë që e meritojnë adhurimin, në qoftë se jeni të sinqertë në këtë pretendim.

أَمَّنْ يَبْدُوْا الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيْدُهُ وَمَنْ يَرْزُقُكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَءِلَٰهٌ مَّعَ اللَّهِ

“A ka më të mirë se Ai, që nis krijimin dhe pastaj e ripërsërit atë, që ju jep mjete jetese nga qielli dhe toka?! Vallë, a ka krahas Allahut të adhuruar të tjerë që e meritojnë adhurimin?”¹⁹

Askush. Kush pretendon diçka të tillë, le të sjell argument. Porse ata nuk kanë as argumentin më të vogël, më të vogël, më të vogël sesa një thërmijë. Allahu na ruajt.

Këto janë ajete madhështore me të cilat Allahu u tërheq vëmendjen atyre që kanë logjikë të ndritur dhe që shikojnë; ndërsa atij që Allahu ia ka verbuar zemrën dhe ia ka shurdhuar veshët s’përfiton dot nga gjithë këto gjëra.

Ai e pranon se Allahu është Krijuesi i qiejve dhe i tokës, dhe se Ai krijoi xhinët dhe njerëzit dhe ka krijuar e ka krijuar... por cili është rezultati?

¹⁸ En-Neml, 64.

¹⁹ En-Neml, 64.

Rezultati është kufri, Allahu na ruajt. Allahu na dhëntë mirëqenie. Kurse Allahu i Përsosur e i Lartësuar nga çdo e metë thotë:

أَفَلَمْ يَنْظُرُوا إِلَى السَّمَاءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنَاهَا وَزَيَّنَّاهَا وَمَا لَهَا مِنْ فُرُوجٍ ﴿٦٧﴾ وَالْأَرْضَ
مَدَدْنَاهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ وَأَنْبَتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجٍ بَهِيجٍ ﴿٦٨﴾

“A nuk e shohin ata qiellin që qëndron sipër tyre, si e kemi ndërtuar dhe zbukuruar, pa pasur kurrfarë plasaritje në të? Ndërsa Tokën e kemi shtruar dhe në të kemi shpërndarë male të palëvizshme dhe kemi bërë, që nga ajo, të mbijnë gjithfarëlloj bimësh të bukura.”²⁰

Allahu Ekber (Allahu është më i Madhi), gjithfarëlloj bimësh të bukura. Ndërsa një poet thotë:

*Medito bimët e tokës dhe shiko Mbreti ç'ka krijuar,
sy të argjendtë që me vëmendje vështrojnë,
me bebëza syri që janë si flori i praruar,
kallamet dhe gurët e çmuar, të gjitha dëshmojnë
se pos Allahut me hak s'ka tjetër të adhuruar.*

Pra, erdhi ky njeri (Ebij Neuasi, autori i këtyre vargjeve) – Allahu e di më së miri – në një kopsht të mrekullueshëm që kulmonte me lulëzimin dhe bukurinë e larmisë së luleve, bimëve, frutave etj. Kështu, ai tha këto vargje të cilat tregojnë Madhësitinë dhe Teuhidin e Allahut të Përsosur e të Lartësuar nga çdo e metë:

*Çudi, si Allahut i bën mëkat gjynahqari,
dhe si e mohon Atë mosbesimtari.
Në çdo gjë ka shenja e dëshmi,
që tregojnë se Ai është i Vetmi.*

I Përsosur dhe i Lartësuar nga çdo e metë është Ai.

²⁰ Kaf, 6-7.

Këto janë fjalë të poetëve, por ama ato rrënjisin Teuhidin e Allahut në zemrat e tyre. E lusim Allahun që të rrënjosë Teuhidin me të gjithë llojet e tij në zemrat dhe sytë tanë.

أَفَلَمْ يَنْظُرُوا إِلَى السَّمَاءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنَاهَا وَزَيَّنَّاهَا وَمَا لَهَا مِنْ فُرُوجٍ ﴿٦١﴾ وَالْأَرْضَ مَدَدْنَاهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ وَأَنْبَتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجٍ بَهِيجٍ ﴿٦٢﴾ تَبْصِرَةً وَذِكْرَى لِكُلِّ

عَبْدٍ مُنِيبٍ ﴿٦٣﴾

“A nuk e shohin ata qiellin që qëndron sipër tyre, si e kemi ndërtuar dhe zbukuruar, pa pasur kurrfarë plasaritje në të? Ndërsa Tokën e kemi shtruar dhe në të kemi shpërndarë male të palëvizshme dhe kemi bërë, që nga ajo, të mbijnë gjithfarëlloj bimësh të bukura, si mjet ndriçimi të mendjes dhe përkujtesë për çdo rob që i drejtohet Zotit të vet.”²¹

Pra, robi i cili i kthehet Allahut, që është i devotshëm dhe i mirë, i cili e madhëron Allahun ashtu siç i takon Atij – i Përsosuri dhe i Lartësuar nga çdo e metë – mediton për këto ajete, si mjet ndriçimi të mendjes dhe përkujtesë për çdo rob që i kthehet Zotit të vet. Ato e bëjnë që të meditojë dhe e nxisin që të kthehet te Allahu duke e madhëruar dhe lartësuar Atë.

وَنَزَّلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً مُبْرَكًا فَأَنْبَتْنَا بِهِ جَنَّاتٍ وَحَبَّ الْحَصِيدِ ﴿٦٤﴾ وَالنَّخْلَ بَاسِقَاتٍ لَهَا طَلْعٌ نَضِيدٌ ﴿٦٥﴾ رِزْقًا لِلْعِبَادِ وَأَحْيَيْنَا بِهِ بَلْدَةً مَيْتًا كَذَلِكَ الْخُرُوجُ ﴿٦٦﴾

“Ne lëshojmë nga qielli ujë të bekuar dhe nëpërmjet tij krijojmë kopshte, drithëra që korren dhe palma hurme të larta me tufa frutash njëra mbi tjetrën, si ushqim për robërit Tanë; në këtë mënyrë Ne me shi e ringjallim tokën e vdekur. E kështu do të jetë edhe ringjallja.”²²

Dhe këto ajete janë argument që tregojnë se Allahu i Përsosur dhe i Lartësuar nga çdo e metë është Krijuesi i këtij universi dhe Rregulluesi i

²¹ Kaf, 6-8.

²² Kaf, 9-11.

tij, me Fuqinë, Dijen, Urtësinë, Madhështinë dhe Lartmadhërinë e Tij, i Përsosuri dhe i Lartësuari nga çdo e metë dhe Ai është që meriton të adhurohet. Gjithashtu, ato janë argument për Fuqinë e Allahut të Përsosur e të Lartësuar që t'i ringjallë krijesat.

Pra, Ai që ka krijuar këtë gjithësi dhe këto krijesa madhështore, duke filluar që nga qiejt dhe tokat, kodrat, detet, bimët, kafshët e kështu me radhë, është i Plotfuqishëm t'i ringjallë ata që kanë vdekur. Madje ringjallja është më lehtë për Të se sa fillimi i krijimit. Risjellja në jetë e krijesave është më e lehtë për Allahun e Përsosur e të Lartësuar nga çdo e metë, sikurse Ai ka thënë në suren er-Rum:

وَهُوَ الَّذِي يَبْدَأُ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ وَهُوَ أَهْوَنُ عَلَيْهِ

“Ai e nis krijimin dhe Ai e përsërit atë e për Atë kjo është edhe më e lehtë...”²³

Pra kthimi në jetë i krijesave për Atë është më i lehtë se fillimi i krijimit të tyre.

Ka ajete të shumta lidhur me këtë temë, të cilat kanë nevojë për njerëz që reflektojnë me to dhe dëshmon me to Teuhidin e Allahut – *Tebarake ue Te'ala*. I gjithë ky univers madhështor dhe këto krijesa qiellore dhe tokësore, të gjitha ato e lavdërojnë Allahun – *Tebarake ue Te'ala*, e madhërojnë dhe i bëjnë sexhde (i përulen) të Përsosurit e të Lartësuarit nga çdo e metë, dhe këto veprime janë të vërteta por që ne nuk i perceptojmë dot:

تُسَبِّحُ لَهُ السَّمَوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ وَلَكِنْ

لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ إِنَّهُ كَانَ حَلِيمًا غَفُورًا ﴿٦٦﴾

²³ Er-Rrum, 27.

“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka gjë që nuk e madhëron Atë duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës.”²⁴

Këto krijesa ne i shohim sikur nuk kanë intelekt, porse ato e madhërojnë Allahun e Përsosur e të Lartësuar nga çdo e metë; e tërë kjo gjithësi, çdo gjë në të, e vogël apo e madhe, tërheqëse apo jo, që të gjithë ato e madhërojnë Allahun – *Tebarake ue Te’ala*.

أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يَسْجُدُ لَهُ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ
وَالنُّجُومُ وَالْجِبَالُ وَالشَّجَرُ وَالدَّوَابُّ وَكَثِيرٌ مِّنَ النَّاسِ وَكَثِيرٌ حَقَّ عَلَيْهِ الْعَذَابُ
وَمَنْ يُنِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ مُّكْرِمٍ إِنَّ اللَّهَ يَفْعَلُ مَا يَشَاءُ ﴿١٨﴾

“A nuk e sheh ti se, në të vërtetë, Allahut i përulen në sexhde ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, edhe Dielli, edhe Hëna, edhe yjet, edhe malet, edhe drurët, edhe kafshët dhe shumë nga njerëzit? Por ka shumë njerëz (mohues), që meritojnë dënimin. E atë që e poshtëron Allahu, askush nuk mund ta bëjë të nderuar. Allahu, me të vërtetë, bën çfarë të dëshirojë.”²⁵

Pra, këto planete, yje, qiej dhe këto toka i bëjnë sexhde Allahut – *Tebarake ue Te’ala* – dhe për këtë kanë ardhur ajete. Kodrat dhe shpezët e madhërojnë Atë. Ka thënë Allahu – *Tebarake ue Te’ala*:

وَأَذْكُر عَبْدَنَا دَاوُدَ ذَا الْأَيْدِ إِنَّهُ أَوَّابٌ ﴿١٧﴾ إِنَّا سَخَرْنَا الْجِبَالَ مَعَهُ يُسَبِّحْنَ
بِالْعَشِيِّ وَالْإِشْرَاقِ ﴿١٨﴾ وَالطَّيْرَ مَحْشُورَةً كُلٌّ لَهُ أَوَّابٌ ﴿١٩﴾

²⁴ El-Isra`, 44.

²⁵ El-Haxh, 18.

“Kujtoje robin Tonë të fuqishëm, Daudin, që përherë i drejtohej Zotit. Ne ia nënshtruam malet që, bashkë me të, t’i luteshin Allahut, në mbrëmje dhe në mëngjes, edhe shpendët e tubuar. Të gjithë i drejtoheshin Atij.”²⁶

Pra, robi i Allahut që i drejtohej Atij, Daudi, që ishte Pejgamber dhe gjykatës – *alejhis-salatu ues-selam*, ishte nga ata që më së shumti e adhuronin Allahun.

وَأَذْكُرْ عَبْدَنَا دَاوُدَ ذَا الْأَيْدِ إِنَّهُ أَوَّابٌ

“Kujtoje robin Tonë të fuqishëm, Daudin, që përherë i drejtohej Zotit.”

D.m.th fuqia e tij në adhurim.

إِنَّهُ أَوَّابٌ

“...që përherë i drejtohej Zotit.”

I kthyer tek Allahu – *Tebarake ue Te’ala*. Vërtet Ne i kemi nënshtruar kodrat si nder për të (Daudi, ‘*alejhis-selam*). Këto janë mrekullitë e Pejgamberëve – ‘*alejhimus-salatu ues-selam*. Dhe nga faktet më madhështore që tregojnë për vërtetësinë e Pejgamberëve – ‘*alejhimus-salatu ues-selam*, është ajo që ka thënë i Dërguari Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*:

" ما من نبي إلا آتاه الله من الآيات ما آمن عليه البشر، وإنما الذي أوتيته وحياً أوحاه الله إليّ "

“Nuk ka pasur Profet përveç se Allahu i ka dhënë shenja që njerëzit t’i besojnë atij, ndërsa ajo që më është dhënë mua është shpallje që Allahu ma shpalli mua.”

Lavdërimi dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Pra, zogu ka bërë tesbih (d.m.th. ka madhëruar Allahun) bashkë me Profetin e Allahut Daudin, edhe kodrat kanë bërë tesbih bashkë me të në mëngjes e në mbrëmje. Ato (kodrat) bënin me të vërtetë tesbih me të vazhdimisht. Këto janë disa prej

²⁶ Sa’d, 17-19.

argumenteve që tregojnë se të gjitha këto krijesa e madhërojnë Allahun, i nënshtrohen Allahut, e shenjtërojnë Allahun dhe e lartësojnë Allahun Krenar e Madhështor nga çdo mangësi.

Ndërsa ky njeri i gjorë merr krahas Allahut të barabartë dhe ortakë (në adhurim), i cili fatkeqësisht bie në gjynahe, krime dhe vepra të shëmtuara, ndonëse të gjitha këta qenie madhështore, siç janë qielli, toka, yjet, kodrat, pemët dhe të gjitha këto krijesa e madhërojnë Allahun, e shenjtërojnë Atë dhe e pastrojnë nga çdo e metë Allahun e Përsosur e të Lartësuar. Këto ajete i përmend Allahu – *Tebarake ue Te’ala* – në Librin e Tij. Pra, me këto ajete Ai nxit ndërgjegjen njerëzore që ata të paktën të ndjekin rrugën e këtyre trupave të ngurtë të cilat e madhërojnë Allahun, i nënshtrohen Atij, e njësojnë Atë, e adhurojnë Atë, dhe e pastrojnë Atë nga të paturit ortakë, të barabartë, të njësojtë apo ndihmës. I Përsosur dhe i Lartësuar nga çdo e metë është Ai.

Pasha Allahun, disa prej këtyre ajeteve i mjaftojnë atij që ka logjikë që adhurimin e tij t’ia dedikojë Allahut – *Tebarake ue Te’ala* – dhe të mos i japë askujt tjetër asnjë grimcë nga e drejta e Allahut.

Vijmë tek hadithi. Dhe kjo ishte parathënie e hadithit. Mu’adhi ka qenë fekihi (dijetar me kuptim të thellë të Islamit), për fik`hun e të cilit dëshmoi i Dërguari i Allahut dhe se ai ishte më i dituri i Sahabëve për hallallin dhe haramin – *radij-Allahu ‘anhu*. I Dërguari e donte atë.

يا معاذ أني لأحب لك ما أحب لنفسي، فوالله أني لأحبك فلا تدعن أن تقول
اللهم أعني على ذكرك وشكرك وحسن عبادتك.

“O Muadh unë dua për ty atë që dua për veten time, pasha Allahun unë të dua ty, andaj mos të të ikë pa thënë “O Allah më ndihmo të të përmend dhe të të falenderoj dhe të të adhuroj sa më mirë.”

Pra, ai ishte një prej atyre që i Dërguari i Allahut – *‘alejhis-salatu ues-selam*, e donte, e nderonte si dhe e ka hipur mbas tij në të njëjtën kafshë udhëtimi në një ditë prej ditëve, pastaj i dha atij këtë mësim madhështor:

يا معاذ أتدري ملحق الله على عباده؟

*“O Muadh, a e din cila është e drejta e Allahut mbi robërit e tij?” Ai tha:
“Allahu dhe i Dërguari i Tij e din më së miri.”*

Kjo është edukatë. E nuk ka dyshim që Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri. Ai tha:

حق الله على عباده أن يعبدوه ولا يشركوا به شيئا

“E drejta e Allahut mbi robërit e tij është që ta adhurojnë Atë dhe të mos i shoqërojnë Atij asgjë në adhurim.”

Kjo është një fjalë e madhe që përmban të drejtën e Allahut, që Teuhidi i të Përsosurit dhe të Lartësuarit nga çdo e metë, si dhe përmban mohimin e shirkut dhe ortakëve ndaj Allahut – *Tebarake ue Te’ala*.

“Që ta adhurojnë Allahun dhe të mos i shoqërojnë gjë Atij,” asgjë prej gjëje, pra të mos adhurojnë bashkë me të ndonjë gjë prej gjëje, apo t’i dedikohet dikujt tjetër në vend të Allahut diçka, qoftë edhe sa një grimcë prej adhurimit. Dhe fjala “gjë” këtu mund të ketë për qëllim gjërat që adhurohen, pra të mos adhurojnë krahas Atij ndonjë gjë prej atyre gjërave që adhurohen; ose mund të ketë për qëllim adhurimin, pra që robi të mos i japë dikujt tjetër pos Allahut diçka prej adhurimeve, qoftë edhe sa një grimcë.

Kjo është nga argumentet e Teuhidit Uluhije dhe për këtë temë ka ajete dhe hadithe të panumërta:

وَأَعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا^ط

“Dhe adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim).”²⁷

²⁷ En-Nisa`, 36.

يَأَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٢١﴾ الَّذِي

جَعَلَ لَكُمْ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنْ

الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ ۖ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٢﴾

“O njerëz. Adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat), i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë, i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos i sajoni Allahut të barabartë (në adhurim) ndërkohë që ju e dini (se askush nuk është i barabartë me Atë).”²⁸

Ju e dini se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi dhe Ai është që e zbret shiun dhe i bën bimët të mbijnë, kur i dini të gjitha këto si i bëni Atij të barabartë? Pra, mos i bëni Atij të barabartë kur ju e dini. Këto janë nga argumentet e obligueshmërisë së veçimit të Allahut me adhurim. Ky Zot Madhështor që na ka krijuar neve dhe ka krijuar ata para nesh, ka krijuar qiejt dhe tokën, e zbret shiun dhe i bën bimët që të mbijnë, e kështu me radhë. Ky është Ai që e meriton adhurimin i vetëm, i Përsosuri dhe i Lartësuari nga çdo e metë.

Nuk e meriton adhurimin as ndonjë engjëll i afërt, as ndonjë një pejgamber i dërguar, as, as, as... përveç se Ai. Kështu që, nuk i lutesh askujt tjetër përveç Atij, nuk kërkohet ndihma nga dikush tjetër përveç Atij, kur je në vështirësi nuk kthehesh tek askush tjetër përveç Atij, të Përsosurit e të Lartësuarit nga çdo e metë. Nuk i falesh e nuk i bën sexhde askujt përveç Atij, të Përsosurit e të Lartësuarit nga çdo e metë. Nuk i mbështetesh askujt përveç Atij, si dhe nuk i mban shpresat tek askush përveç se tek Ai, sepse këto janë prej adhurimeve.

O ju njerëz, adhuroni Zotin tuaj me adhurime të shumta. Dhe adhurimi është një urdhër që përmbledh çdo gjë që Allahu e do dhe është i kënaqur me të, prej fjalëve dhe veprave të dukshme apo të fshehta.

²⁸ El-Bekarah, 21-22.

Pra, adhurimi i përmbledh të gjitha urdhrat me të cilat Allahu i Përsosur e i Lartësuar nga çdo e metë i ka ngarkuar robërit e Tij. Ata e kanë obligim që t'i zbatojnë ato urdhra dhe të qëndrojnë larg të ndaluarave që ua ka ndaluar Allahu. Kështu që, ata e kanë detyrë që të largohen prej atyre ndalesave dhe t'i konsiderojnë të ndaluara ashtu siç ua ka ndaluar Allahu atyre, duke qenë kjo adhurim, përlje dhe nënshtrim për Allahun e Përsosur e të Lartësuar nga çdo e metë. Adhurimet janë të shumta dhe ajetet në lidhje me to janë të shumta. Dhe ka thënë i Lartësuari:

وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا

“Dhe Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit.”²⁹

Jusufi – *alejhis-salatu ues-selam*, kur po ftonte ata që e shoqëronin në burg në fenë e Ibrahimit – *alejhis-salatu ues-selam*, në Teuhidin e Allahut – *Tebarake ue Te’ala*, u tha me këshillën e tij duke ua bërë të lehtë thirrjen:

إِنِ الْحُكْمُ إِلَّا لِلَّهِ أَمَرَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ

“Me të vërtetë gjykimi i përket vetëm Allahut; Ai ka urdhëruar që të mos adhuronit askënd tjetër përpos Atij.”³⁰

Ndërsa ishte duke i ftuar, ai u tha atyre:

أَرْبَابٌ مُّتَفَرِّقُونَ خَيْرٌ أَمِ اللَّهِ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ ﴿٦٠﴾

²⁹ El-Isra`, 23.

³⁰ Jusuf, 40.

“A janë më mirë një mori zotash të ndryshëm apo Allahu, i Vetmi, Nënshtruesi?”³¹

مَا تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِهِ إِلَّا أَسْمَاءَ سَمَّيْتُمُوهَا أَنْتُمْ وَآبَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ
سُلْطَانٍ إِنْ الْحُكْمُ إِلَّا لِلَّهِ أَمَرَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ

“Ata që ju i adhuronin në vend të Allahut, janë vetëm emra, të cilët i keni vënë ju dhe të parët tuaj, pa pasur prej Tij asnjë argument. Me të vërtetë gjykimi i përket vetëm Allahut: Ai ka urdhëruar që të mos adhuronit askënd tjetër përpos Atij.”³²

Gjykimi i përket vetëm Allahut, të Përsosurit e të Lartësuarit nga çdo e metë. Dhe ky ajet është nga argumentet më të mëdha që vërteton se Hakimija (qeverisja) me ligjin e Allahut – *Tebarake ue Te’ala* – fillon me Akiden. Mirëpo ekzistojnë thirrje (davete) që fillojnë me politikë, thirrje që fillojnë me besëtytni, me sufizëm dhe devijim, pra thirrje, drejtime të shumta të cilat kanë devijuar nga rruga e Pejgamberëve, lavdërimet dhe bekimet qofshin mbi ta.

Të gjithë Pejgamberët erdhën duke i thirrur popujt në veçimin e Allahut – *Subhanehu ue Te’ala* – të vetëm në adhurim. Pra, që ta njësojnë Allahun me adhurim. Kështu që, adhurimet të cilat i ka ligjësuar Allahu – *Tebarake ue Te’ala* – hyjnë në gjykimin e tij dhe adhurimet janë dispozitat e para të cilat njerëzit obligohen t’i marrin përsipër.

Disa njerëz hyjnë në fushën e politikës me parulla si, “Gjykimi i përket vetëm Allahut”, “S’ka gjykues tjetër përveç Allahut”, pra hyjnë në fushën e politikës në Islam, kurse Akides nuk i kthehen dhe nuk e kuptojnë e nuk e dinë se Akideja është në shkallën e parë për të hyrë në Hakimijen e Allahut – *Tebarake ue Te’ala*. Kuptojeni këtë o vëllezër!

³¹ Jusuf, 39.

³² Jusuf, 40.

Ata trumbetojnë: “Nuk ka gjykues tjetër përveç Allahut, nuk ka gjykues tjetër përveç Allahut, nuk ka gjykues tjetër përveç Allahut.” Po, pasha Allahun ne e themi këtë dhe e themi me bindje, por ama prej ku fillon kjo Hakimije? Betohem në Allah që ajo fillon prej Akides dhe ky është *menhexhi* (metodologjia) i Pejgamberëve dhe ky është *fik`hu* (kuptimi) i Pejgamberëve dhe ky është *da`ueti* (thirrja) e Pejgamberëve dhe kjo është thirrja e Kuranit që nga fillimi e deri në mbarimin e tij.

Kjo për shkak se Kur'ani - sikurse thotë Ibnul-Kajjim - i tëri flet për Teuhid, i tëri flet për Teuhid, sepse Kurani ose njofton për Allahun, për Emrat e Tij dhe Cilësitë e Tij, pra ai është Teuhidi që të jep njohuri dhe të informon, domethënë *Teuhidi Rububije* (Teuhidi i Veprave të Allahut) dhe *Teuhidi el-Esma`ues-Sifat* (Teuhidi i Emrave dhe Cilësive të Allahut), ose Kurani është thirrje për në adhurimin e Allahut – *Subhanehu ue Te'ala* – dhe ndalim nga të bërit shirk Atij, dhe ai është Teuhidi i dëshirës, Teuhidi i dëshirës dhe i qëllimit (*Teuhid el-Iraadeh uel-Kasd*), domethënë Allahu na urdhëron që ta veçojmë Atë me adhurim, pra nuk duam me adhurim askënd tjetër përveç Atij, të Përsosurit e të Lartësuarit nga çdo e metë. Ky është Teuhidi i kërimit dhe qëllimit, *el-istigatheh* (të kërkuarit ndihmë në raste vështirësie dhe frike), ne kërkojmë ndihmë nga Allahu dhe i lutemi vetëm Allahut, i kërkojmë Atij për plotësimin e nevojave tona dhe largimin e brengave tona, e kështu me radhë. Ky është Teuhidi i adhurimit, që nga namazi, agjërimi, zekati..., ai që falet kërkon dhe i lutet Allahut për shpërblim, ky është Teuhidi i adhurimit.

Teuhidi i kërimit është që t'i kërkosht Allahut – ‘*Azze ue Xhel-le* – atë që do t'ia kërkosht, që të të fal ty, të të mëshiroj, të ta largoj dëmin që të ka goditur, e kështu me radhë. Ky është Teuhidi i kërimit dhe qëllimit.

Ose Kurani sjell habere për njerëzit e Teuhidit, ç'ka bërë Ai me ta në dynja dhe si do t'i nderojë ata me të (Kuranin) në Botën Tjetër. Dhe kjo është nga të drejtat e Teuhidit apo shpërblimi i Teuhidit, Teuhidi i kërimit apo Teuhidi për urdhërim dhe ndalim, dhe kjo është nga plotësuesit e Teuhidit. Ose ai sjell habere për nderimin që Allahu u ka bërë robërve të Tij besimtarë në këtë botë, si dhe nderimin që do t'ua bëj në Botën Tjetër. Dhe ky është shpërblimi i atyre që e mbajtën Teuhidin.

Unë po u përcjell fjalët e Ibn Kajjimit, domethënë kuptimin e tyre.

Ose ai sjell habere për ndëshkimet që u kanë rënë armiqve të Allahut në dynja dhe dënimin që do të zbresë mbi ta në botën tjetër, dhe ky është gjykimi për atë që e braktis Teuhidin.

Pra, i gjithë Kur’ani vërtitet rreth Teuhidit, si dhe rreth gjykimeve dhe shpërblimit të tij. Ky Kur’an është i tëri Teuhid. Ku e gjen këtë përqendrim tek grupet e devijuara të politikës, të sufistëve, të rafidijve dhe të tjerë pos këtyre. Nuk e gjen këtë dituri te ata, nuk e gjen! Dhe për këtë shkak ata janë të lidhur mbas adhurimit të varreve, janë të lidhur mbas besëtytnive ose nuk e çajnë kokën për adhurimin e varreve apo për gjëra të tjera të kësaj natyre. Nuk ka dallim në mes adhurimit të idhujve dhe adhurimit të varrit, nuk ka dallim në mes atij që i lutet Latit dhe Uzasë dhe atij që i lutet të vdekurit apo atij që mungon, të gjithë ata u luten të tjerëve pos Allahut: ky që i lutet idhujve po i lutet të tjerëve në vend të Allahut, edhe ai që i lutet të vdekurve po i lutet të tjerëve në vend të Allahut.

فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا ﴿١٨﴾

“Prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut.”³³

وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّن يَدْعُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ مَنْ لَا يَسْتَجِيبُ لَهُ إِلَى يَوْمِ الْقِيَمَةِ وَهُمْ عَنِ

دُعَائِهِمْ غَافِلُونَ ﴿١٩﴾ وَإِذَا حُشِرَ النَّاسُ كَانُوا لَهُمْ أَعْدَاءً وَكَانُوا بِعِبَادَتِهِمْ كَافِرِينَ ﴿٢٠﴾

“E kush është më i humbur se ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre që nuk mund t’u përgjigjen deri në Ditën e Kijametit e që janë krejt të pavetëdijsëm ndaj lutjes së tyre?! Kur të tubohen njerëzit (në Ditën e Gjykimit), ata (të adhuruarit) do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre.”³⁴

³³ Xhinn, 18.

³⁴ El-Ahkaf, 5-6.

Nuk ka më të devijuar se sa ata që u luten të tjerëve përveç Allahut, Pejgamberët nuk janë të njëjtë me Allahun, engjëjt nuk janë të njëjtë me Allahun, pemët nuk janë të njëjta me Allahun, të vdekurit dhe njerëzit e mirë nuk janë të njëjtë me Allahun, ata që s’janë të pranishëm mes njerëzve nuk janë të njëjtë me Allahun, pra nuk ka më të devijuar se ai që i lutet dikujt tjetër përveç Allahut, sepse ata që nuk janë të njëjtë me Allahun nuk posedojnë gjë për t’iu përgjigjur lutjeve, përkundrazi, ata as nuk e dëgjojnë lutjen.

إِنْ تَدْعُوهُمْ لَا يَسْمَعُوا دُعَاءَكُمْ وَلَوْ سَمِعُوا مَا اسْتَجَابُوا لَكُمْ وَيَوْمَ الْقِيَمَةِ يَكْفُرُونَ

بِشْرِكِكُمْ وَلَا يُنَبِّئُكَ مِثْلُ خَبِيرٍ ﴿١٤﴾

“Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t’ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kijametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm.”³⁵

Prandaj, o ju të rinj, e kemi detyrë që të kuptojmë thirrjen e Pejgamberëve – *alejhimus-salatu ues-selam* – të cilën e ka vendosur Allahu në Librin e Tij në shumë ajete, njëri prej të cilave është:

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun...”³⁶

Çdo i Dërguar ka shkuar te populli i tij dhe i ka thirrur për në adhurimin e Allahut – *Tebarake ue Te’ala* – dhe i ndalonte nga të bërit Allahut ortakë e të barabartë. E para gjë që kanë dëgjuar popujt nga Pejgamberët është kjo thirrje për të adhuruar vetëm Allahun – *Subhanehu ue Te’ala*, sepse njerëzit pohojnë në përgjithësi se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Ai që jep jetë dhe vdekje.

³⁵ Fatir, 14.

³⁶ En-Nahl, 34.

مَا نَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ

“Ne nuk i adhurojmë ata përveç se që të na afrojnë tek Allahu.”³⁷

Ata e pranojnë që këta (idhuj) nuk krijojnë, nuk japin jetë dhe vdekje, e kështu me radhë, porse ata i marrin si ndërhyrës dhe ndërmjetësues te Allahu. Këtë ndërhyrje e ndërmjetësim Allahu e ka hedhur poshtë dhe e konsideron kufër dhe shirk ndaj Tij.

مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ

“Kush është ai që mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?”³⁸

أَمِ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ شُفَعَاءَ قُلْ أُولَٰئِكَ كَانُوا لَا يَمْلِكُونَ شَيْئًا وَلَا يَعْقِلُونَ ﴿٤٣﴾

قُلْ لِلَّهِ الشَّفَاعَةُ جَمِيعًا لَهُ مَلِكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ثُمَّ إِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٤٤﴾

“A zgjedhin ata, përveç Allahut, ndërmjetësues të tjerë (që gjoja do t’i afrojnë pranë Allahut)?! Thuaj: Vallë, a i merrni edhe pse nuk kanë asgjë në dorë dhe nuk kuptojnë?! Thuaju: Ndërmjetësimi është i gjithi në duart e Allahut; Ati i takon pushteti i qiejve dhe i Tokës e pastaj tek Ai do të ktheheni.”³⁹

Pra, e kemi për detyrë që ta njohim Teuhidin e Ibadetit dhe Teuhidin Rububije nëpërmjet këtyre ajeteve me të cilat është i stolisur Kur’ani. Teuhidin e adhurimit po ashtu e njohim nga ajetet të cilat sqarojnë se Allahu është i adhuruari i vetëm, si dhe tregojnë se kjo është thirrja e Pejgamberëve dhe se kjo thirrje përqendrohej te ky Teuhid. E kemi për detyrë që t’ia vëmë veshin Kur’anit dhe të meditojmë e të reflektojmë rreth tij. Ky Teuhid është mesazhi i të gjithë Pejgamberëve – *alejhimus-salatu ues-salam* – ky është pikë-takimi i të gjitha thirrjeve të tyre.

Pejgamberët kanë edhe direktiva të tjera si dhe baza në të cilat thërrasin, porse ky është boshti kryesor para çdo gjëje, përndryshe ata thërritnin që

³⁷ Ez-Zumer, 3.

³⁸ El-Bekarah, 255.

³⁹ Ez-Zumer, 43-44.

të besohej në shpallje, të besohej në Ditën e Fundit, të besohej në Pejgamberët; është obligim për çdo krijesë që të besojë se Allahu ka çuar të Dërguar përgëzues dhe paralajmërues.

Pra, Pejgamberët erdhën me të gjithë këtë, të mëparshmit përgëzonin ata që vinin mbas tyre dhe i thërrisnin të mëvonshmit që të besonin ata që kishin ardhur para tyre dhe feja e të gjithë atyre ishte një. Thotë i Lartësuari:

إِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ ﴿٩٢﴾

“Vërtet, ky është besimi juaj - besimi i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuroni Mua.”⁴⁰

Këtë e ka thënë pasi që i ka përmendur disa rrëfime të Pejgamberëve dhe pas atyre rrëfimeve tha:

إِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ ﴿٩٢﴾

“Vërtet, ky është besimi juaj - besimi i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuroni Mua.”⁴¹

Pra, Pejgamberët – *alejhimus-salatu ues-selam* – erdhën për ta udhëzuar njerëzimin para çdo gjëje tjetër, si dhe t’i shpëtonin nga shirku dhe devijimi, ndërkohë që politikat ishin të pranishme, politikat e devijuara dhe të prishura gjendeshin në çdo popull, mirëpo rruga e të gjithë Pejgamberëve – lavdërimi dhe bekimi qoftë mbi të gjithë ata – ishte se ata fillonin duke thirrur tek dëshmia “**La ilahe il-Allah**”. Çfarë kuptimi ka dëshmia “**La ilahe il-Allah**”? Kuptimi i saj është: **Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.**

Ithtarët e skollistikës, logjikës dhe filozofisë thonë: “Nuk ka krijues, nuk ka furnizues përveç Allahut.” Po, Pasha Allahun, nuk ka krijues tjetër,

⁴⁰ El-Enbija, 92.

⁴¹ El-Enbija, 92.

nuk ka furnizues tjetër përveç Allahut, porse nuk është ky kuptimi i fjalës “**La ilahe il-lAllah**”, nuk ka krijues dhe furnizues tjetër. Ka ajete të shumta, mes të cilave ajetet që ua lexuam, të cilat tregojnë që Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Sistemuesi i çështjeve të kësaj gjithësie dhe Rregulluesi i saj, i Përsosuri e i Lartësuar nga çdo e metë, mirëpo ky është Teuhidi Rububije, ajetet e të cilit argumentojnë për Teuhidin Uluhije. Nëse besoni se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, atëherë kjo ju detyron që ta adhuroni Këtë Krijues e Furnizues.

Shpjegimi i ithtarëve të skolastikës/filozofisë i ka çuar shumë grupe në devijim, sepse nga fjala “*La ilahe il-lAllah*” ai kupton që nuk ka krijues dhe furnizues tjetër, prandaj thotë: “Unë besoj se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, dhe nuk besoj se filani të cilit i lutem, i bëj sexhde, përulem në ruku dhe bëj tauaf rreth varrit të tij, unë nuk besoj se ai është krijuesi, furnizuesi.”

Në rregull, ky njeri nuk e ka kuptuar që domethënia e fjalës “**La ilahe il-lAllah**” është: nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut. Domethënia e fjalës “**La ilahe il-lAllah**” është: se vetëm për Atë është sexhdeja, tauafi, rukuja dhe lutja, Ai nuk ka ortak në këto ashtu si dhe në adhurimet tjera, kjo është domethënia e fjalës “**La ilahe il-lAllah**”, kurse ti këtë adhurim ia kushtove tjetërkujt në vend të Allahut dhe i ke bërë Atij të barabartë dhe ortak.

Erdhën disa njerëz të tjerë politikanë dhe thanë: “Nuk ka gjykues tjetër përveç Allahut” dhe ia shtuan Umetit mjerimin dhe injorancën për domethënien e fjalës “**La ilahe il-lAllah**”. Ky shpjegimi i tyre sikur të shpie në kuptimin “s’ka adhurues tjetër pos Allahut” – shumë i Lartësuar është Allahu nga ajo gjë – shpjegim ky më i lajthitur sesa ai i filozofëve. Dhe këtë devijim nuk e kanë kuptuar shumë prej të mashtruarve nga ky tefsir i devijuar i fjalës “**La ilahe il-lAllah**”.

Ne themi “**La ilahe il-lAllah**”, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut. Ka adhurues dhe ka të adhuruar. Krijesat janë adhurues, e prej tyre janë njerëzit që e adhurojnë Allahun, besimtarët që falin namazin për Të, i bëjnë sexhde Atij, i bëjnë ruku Atij, agjërojnë për hir të Tij, japin zekat për hir të Tij, i mbështeten Atij, ia kanë frikën Atij, i

mbajnë shpresat tek Ai dhe ia përkushtojnë të gjitha këto adhurime këtij të Adhuruari me të drejtë, Allahut, Zotit të Gjithësisë.

Kështu që, kur themi nuk ka gjykues tjetër përveç Allahut, kjo nënkupton se nuk ka adhurues? Ky tefsir është devijim. Andaj, është obligim mbi atë që thërret në këtë shpjegim dhe që beson në Hakimije në këtë mënyrë, që ta ketë frikë Allahun, t'i kthehet Allahut dhe të ndjekë rrugën e Pejgamberëve në thirrjen për te Allahu – *Tebarake ue Te'ala* – dhe ta kuptojë tamam domethënien e vërtetë të fjalës “**La ilahe il-Allah**”.

Shirku është tejet i përhapur në këtë umet, shkon nëpër shtetet (Islame) dhe shikon se si bëjnë tauaf rreth varreve, kërkojnë mbrojtje prej tyre, therin kurban për to, ndërtojnë mbi to xhami, kube dhe mauzole. Në disa shtete shikon qytete të tëra, shikon qytet që është i ndërtuar i gjithi mbi varre. I kundërshtuan hadithet e shumta të cilat e godasin rëndë atë që ndërton xhami mbi varret, ngase ata janë më të këqijët nga krijesat e Allahut dhe mbi ta bie mallkimi i Allahut:

لعنة الله على اليهود والنصارى اتخذوا قبور أنبيائهم مساجد.

“Mallkimi i Allahut qoftë mbi Çifutët dhe të Krishterët, të cilët i kthyen në xhami varret e Pejgamberëve të tyre.”

Hadithi i A'ishes, hadithi i Ebu Hurejrës, hadithi i Ibn ‘Abbasit, hadithi i ‘Alijut – *radij-Allahu ‘anhu* – dhe hadithe të tjera, që të gjitha ato përmbajnë mallkime për ata që i marrin për xhami varret e Pejgamberëve të tyre, që marrin për xhami varret e Pejgamberëve dhe të njerëzve të devotshëm:

إن من كانوا قبلكم كانوا يتخذون قبور الأنبياء والصالحين مساجد
ألا فلا تتخذوا القبور مساجد فإني أنهاكم عن ذلك.

“Vërtet, ata që ishin para jush i merrnin për xhami varret e pejgamberëve dhe të devotshmëve, prandaj mos i merrni varret për xhami se padyshim që unë u ndaloj juve nga kjo.”

Kurse në hadithin e Ibn Mes'udit ka ardhur:

إن من شرار الخلق من تدرّكهم الساعة ومن يتخذون القبور مساجد.

“Vërtet, krijesat më të këqija janë ata që i kaplon Çasti i Fundit dhe ata që i marrin varret për xhami.”

Ka për afërsisht katërmëdhjetë hadithe të konfirmuara. Sufijtë dhe Rrafidat nuk duan t’ia dinë për këto hadithe. Shumë nga dijetarët e këqij në botë po e shpien Umetin në humnerën e shirkut dhe devijimit dhe po i mbrojnë varret ndërsa e luftojnë Teuhidin, e gjer në fund të fatkeqësive të tyre.

Këtu ka një përzierje mes politikës së devijuar dhe besimeve të devijuara, që nga mohimi (t’atili) i cilësive të Allahut – *Tebarake ue Te’ala* – e deri tek vendosja e të barabartëve me Allahun – *Tebarake ue Te’ala*. Pasha Allahun, në disa vende, myftinj të mëdhenj thërrasin në ndërtimin e xhamive mbi varre dhe nuk e bëjnë haram istigathen (kërkimin e ndihmës nga të vdekurit në raste vështirësie apo frike), përkundrazi, ata i luftojnë ata që e bëjnë haram istigathen dhe istinxhaden (kërkimin e ndihmës dhe dermanit) ndaj njerëzve të devotshëm që kanë vdekur.

Kështu që, Umeti është në kulmin e poshtërimit dhe nënçmimit dhe asgjë nuk e shpëton atë nga devijimi, poshtërimi dhe nënçmimi që i ka rënë përveç nëse kthehet në rrugën që ishte i Dërguari dhe Shokët e tij, dhe të ndjekë Akiden sipas menhexhit të të gjithë Pejgamberëve – *alejhimus-salatu ues-selam*, sepse feja e Pejgamberëve është një, feja e Pejgamberëve është një, të gjithë ishin në Teuhid, një gjë e vetme, nuk kishin mospajtime. Ndryshonin në disa kode civile për çështjet e hallalit dhe haramit e për gjëra të kësaj natyre.

Pra, Kur`ani është përplot i mbushur me Teuhid dhe Suneti është përplot me Teuhid. Kur`ani është i mbushur me Teuhid dhe luftim të shirkut në çdo formë që manifestohet ai dhe Suneti është përplot me luftë ndaj shirkut në çdo formë dhe pamje.

فَإِنَّهَا لَا تَعْمَى الْأَبْصَارُ وَلَكِنْ تَعْمَى الْقُلُوبُ الَّتِي فِي الصُّدُورِ ﴿٤١﴾

“Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në krahavor.”⁴²

Ne nuk bëjmë tekfir mbi këta devijuar, mirëpo ata janë të devijuar dhe e shkatërrojnë Umetin. Ne nuk bëjmë tekfir mbi ta derisa t'u ngrihet argumenti për atë që u luten të tjerëve përveç Allahut – nga llojet më të fëlliqura të shirkut – si edhe therja për dikë tjetër pos Allahut dhe të kërkuarit ndihmë prej dikujt tjetër pos Allahut, që janë nga llojet më të fëlliqura të shirkut. Madje ata shkuan edhe më larg se aq, saqë besojnë se eulijatë e dinë të fshehtë (gajbin) dhe vënë në lëvizje universin.

Shiko të gjitha thirrjet (davatet) e tjera jo-selefije, sidomos thirrjet e pranishme sot që po përhapen në botën Islame, siç është thirrja e Ikhuhanul-Musliminëve dhe thirrja e Xhematit Teblig, a i sheh ata t'i luftojnë këto shirkijate?

Jo, pasha Allahun! Madje ata i mbrojnë këto shirkijate, i përkrahin ithtarët e këtyre shirkijateve dhe i mbrojnë. Si kështu? Sepse ata janë ithtarë të thirrjeve politike ku synimi i tyre është që t'i grumbullojnë njerëzit që me këtë grumbullim të arrijnë të marrin karriget e pushtetit.

Islami! Islami! Çka është Islami tek ata? As nuk e luftojnë adhurimin e varreve, as nuk thërrasin për të pasuar Pejgamberët, as këtë e as atë... veçse thirrje për të arritur karriget e pushtetit nën parullën “la Hakim ilAllah – nuk ka gjykues tjetër përveç Allahut” apo gjëra të ngjashme.

Ndërsa lutjet (edhkar) dhe murmurimat në të cilat ka shirkijate, besëtytni dhe bidate dhe në të cilat ka *hulul* (besim kinse Allahu gjendet i mishëruar në çdo send), në të cilat ka *uahdetul-uxhud* (panteizëm), e kështu me radhë. Këto nuk janë të këqija tek këta dhe nuk meritojnë luftë, përkundrazi ata mendojnë se Daveti Selefij i përçan Muslimanët. I përçan Muslimanët, do të thotë se ata janë një xhemat i ngritur mbi besëtytni dhe devijime. Nëse i thërret ata dhe ndonjë grup prej tyre i përgjigjen thirrjes dhe kapen pas Teuhidit, kurse një grup mbetet në shirkun e tyre, atëherë thuhet, “Ti po bën përçarje në mes tyre.” Ma shaa`Allah, kjo është përçarja që sollën Pejgamberët!

⁴² El-Haxh, 46.

فَإِذَا هُمْ فَرِيقَانِ تَخْتَصِمُونَ

“Por ata u ndanë në dy grupe, që grindeshin midis tyre.”⁴³

Erdhi Salihu dhe e thirri popullin e tij në Teuhid, një grup i besuan atij kurse një grup e mohuan. Allahu ka thënë për këtë ndodhi:

فَإِذَا هُمْ فَرِيقَانِ تَخْتَصِمُونَ

“Por ata u ndanë në dy grupe, që grindeshin midis tyre.”⁴⁴

Edhe Muhamedi bëri përçarje mes njerëzve, siç ka ardhur në hadithin sahih, mes ithtarëve të Teuhidit dhe ithtarëve të Shirkut. Pra, ky është suneti i Pejgamberëve – *alejhimus-salatu ues-selam*.

Këta kryeneçë, nga injoranca dhe devijimi i tyre e shtrembërojnë Davetin Selefij dhe e konsiderojnë atë përçarje për Muslimanët, prandaj hajde t’i mbledhim njerëzit në shirk dhe devijim. Çka përfituan? Jehudët po i shkelin me këmbë kokat e tyre, i poshtëruan popujt, hindusët, mexhusët dhe mushrikët e me llojet e tyre të ndryshme. Po i poshtërojnë Muslimanët në çdo vend! Cili është shkaku i kësaj? Shkaku është se ata e braktisën menhexhin e Pejgamberëve dhe e braktisën davetin e Pejgamberëve, nuk përfituan nga Kur’ani, nga ajetet e shkoqitura me Teuhid dhe ajetet e shkoqitura me paralajmërim kundër shirkut dhe me kërcënimin e ashpër për ithtarët e tij.

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ

“Vërtet, Allahu nuk fal që t’i shoqërohet diçka tjetër Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë.”⁴⁵

⁴³ En-Neml, 45.

⁴⁴ En-Neml, 45.

⁴⁵ En-Nisa`, 116.

وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَكَأَنَّمَا خَرَّ مِنْ السَّمَاءِ فَتَخْطَفُهُ الطَّيْرُ أَوْ تَهْوِي بِهِ الرِّيحُ فِي مَكَانٍ

سَحِيقٍ

“Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur.”⁴⁶

وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّنْ يَدْعُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ مَنْ لَا يَسْتَجِيبُ لَهُمْ

“Kush është më i humbur se ai, i cili, në vend Allahut, u lutet atyre që nuk mund t’u përgjigjen.”⁴⁷

Atëherë, si i dëgjon këto ajete madhështore e të shkoqitura me luftë ndaj shirkut, dhe pasojat që u bien atyre që bëjnë shirk, e prapëseprapë bie në shirk dhe thua se unë jam Musliman dhe pret sukses e ndihmë nga Allahu! Pasha Allahun, Allahu nuk do të shtoj ty përveçse poshtërim dhe mjerim:

إذا تبايعتم بالعينة ورضيتم بالزرع واتبعتم أذناب البقر سلط الله عليكم ذلاً لا ينزعه عنكم حتى ترجعوا إلى دينكم.

“Kur t’i futeni tregtisë me ‘ijneh (kamatë) dhe të kapeni pas bishtave të lopëve dhe të jeni të kënaqur me bujqësinë dhe ta keni braktisur Xhihadin në Rrugë të Allahut, Allahu ka për të zbritur poshtërim mbi ju, të cilin nuk do t’ua heqë kurrë derisa t’i ktheheni Fesë suaj.”

Këto gjëra të shpien në këtë gjendje, rënia në kamatë, impenjimi me bujqësi e blegtori apo gjëra të ngjashme. Këto gjëra janë mëkate, kurse shirku është më i rëndë se këto. Shirku është më i rëndë se këto. Pra, nëse këto gjëra janë të pranishme, atëherë duhet patjetër t’i kthehemi Allahut, kurse Teuhidi është më parësor e po ashtu edhe braktisja e shirkut është më parësore (sesa braktisja e gjynaheve të përmendura në hadith).

⁴⁶ El-Haxh, 31.

⁴⁷ El-Ahkaf, 5.

Pasha Allahun, kjo është një gjë e rrezikshme, sa po e trumbetojnë këtë sqarim të qartë e të kthjellët thirrësat e Sunetit dhe Teuhidit në të gjitha vendet e botës, duke e thirrur Umetin me tërë forcën që të kthehet në rrugën që ishin Pejgamberët – ‘*alejhimus-salatu ues-selam*, në rrugën që ishte i Dërguari Allahut – *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* – dhe shokët e tij, që të kapen fort pas Librit të Zotit të tyre dhe Sunetit të Pejgamberit të tyre.

Ndërsa thirrësat e këqij, që nga politikanët, adhuresit e varreve, ithtarët e besëtytnive, Rrafidiat, të gjithë këta mblidhen kundër davetit selefij dhe vënë pengesa e barrikada në mes tij dhe njerëzve, me shtrembërime dhe trembje, për ta deformuar imazhin e këtij menhexhi dhe imazhin e njerëzve të tij. Umeti është i goditur me fatkeqësi.

Njerëzit janë sikur devetë, zor të gjesh mes tyre një të përshtatshme për t’i grahur. Mes njëqind njerëzve nuk gjen tek ky umet dikë që logjikon, për fat të keq. Ndërsa sot, un them se njerëzit janë sikur devetë, në një milion nuk gjen mes tyre një të përshtatshme për ta grahur, për fat të keq.

Sot Muslimanët - siç thuhet – kanë arritur në një miliard e njëqind milion, nuk di sa janë në të gjithë botën, porse ata janë siç ka thënë i Dërguari:

عُثَاءُ كَفَّاءُ السَّيْلِ

“Sikur llumi që mbart sipër rryma e ujit.”

Këto janë pasojat e hidhura për shkak të devijimit në Akijde, në Akijden e Pejgamberëve. Pejgamberët erdhën me Teuhidin e Allahut, me tre llojet e tij: Teuhidi Rububije, Teuhidi Ubudije dhe Teuhidi el-Esma`ues-Sifat (i Emrave dhe Cilësive të Allahut). Madje shumë nga muslimanët janë te devijuar edhe në Teuhidin Rububije, besojnë se eulijat e dinë të fshehtën dhe se kanë pushtet mbi universin. Këtë besim nuk e ka patur as Ebu Xhehli dhe vëllezërit e tij nga idhujtarët e mëdhenj dhe trimat e kufrit. Kjo akide nuk ishte tek ata, e si na qenka te muslimanët? Kjo erdhi si rezultat i komplotit të ateistëve të cilët u futën në radhët e ithtarëve të bidatit dhe erdhën me këtë devijim, erdhën me *hulul* (besëtytni se Allahu është i mishëruar në çdo send), erdhën me *uahdetul-uxhud* (panteizëm),

erdhën me shtrembërimin e kuptimeve të Librit të Allahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij, me mohimin e Emrave dhe Cilësive të Allahut, e kështu me radhë.

Kështu që u pllakosën këto errësira mbi shumë prej atyre që i atribuohen Islamit, andaj Allahu zbriti mbi ta poshtërim dhe mjerim. Dhe këtë gjë nuk do t'ua heqë Allahu përveç nëse kapen fort pas Librit të Zotit të tyre dhe Sunetit të Pejgamberit të tyre.

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا وَاذْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنْتُمْ أَعْدَاءً

فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ بِنِعْمَتِهِ إِخْوَانًا

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut dhe mos u përçani. Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij u bëtë vëllezër.”⁴⁸

Kështu që, e kemi për obligim - o ju të rinj - që ta mësojmë thirrjen e Pejgamberëve – ‘*alejhimus-salatu ues-selam*, t'ia përkushtojmë Fenë sinqerisht vetëm Allahut dhe të përpiqemi duke luftuar për ta shpëtuar këtë Umet nga humnera në të cilën e hodhën njerëzit e intrigave dhe kurtheve; njerëzit e intrigave politike, intrigave ateiste, intrigave sekulariste dhe të gjitha intrigave.

E lus Allahun e – *Tebarake ue Te'ala* – që t'i dhurojë këtij Umeti thirrësa të devotshëm e të sinqertë që ta kthejnë Umetin tek rruga që ishte i Dërguari i Allahut dhe Shokët e tij.

⁴⁸ Aali-Imran, 103.

E lus Allahun që ta bëjë realitet këtë. Vërtet Zoti jonë i dëgjon lutjet.

Allahu dërgoftë salavate dhe selame mbi Pejgamberin tonë, Muhamedin, si dhe mbi Familjen e tij dhe Shokët e tij.

Përktheu: Jeton Shasivari

Kontrollloi: Alban Malaj